



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI GJETJET DHE PËRFUNDIMET E
MONITORIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR KUVEND 25 PRILL 2021**

Projekti:
“Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime” mbështetur financiarisht nga Bashkimi
European.

Tiranë, Qershor 2021



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



ISP
INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES
www.isp.com.al



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

Raport Përfundimtar mbi gjetjet dhe përfundimet e monitorimit të Zgjedhjeve për Kuvend të 25 prill 2021

Përgatiti:

- Daniel Prroni, Koordinator Projekti, Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- Anda Kruetani, Asistente Projekti, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Mbikqyrën dhe rishikuan:

- Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- Z. Niazi Jaho, Këshilltar ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “*Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime*”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në partneritet me Civil Rights Defenders dhe Instituti i Studimeve Politike, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”

Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Cel: +355 69 40 75 732

E-mail: office@ahc.org.al

Ëeb site: www.ahc.org.al

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.





PËRMBAJTJA

1. HYRJE	4
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
3. PROCESI PARAZGJEDHOR	11
<i>Publikimi i listave zgjedhore dhe njoftimi me shkrim i zgjedhësve</i>	11
<i>Veprimtaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve</i>	12
<i>Ngritja dhe funksionimi i Komisioneve e Zonave të Administrimit Zgjedhor</i>	14
<i>Ngritja dhe funksionimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit</i>	16
<i>Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave</i>	18
<i>Fushata zgjedhore dhe përdorimi i burimeve shtetërore</i>	19
4. HESHTJA ZGJEDHORE	22
<i>Shpërndarja e materialeve zgjedhore</i>	22
5. PROCESI I VOTIMIT	23
<i>Aspekte procedurale të përdorimit të pajisjes PEI dhe timbroshes së zgjedhësve</i>	23
<i>Zëvendësime të anëtarëve të KQV</i>	24
<i>Cënimi të parimit të fshehtësisë së votës</i>	24
<i>Orientim/shoqërim i zgjedhësve nga persona të paautorizuar, anëtarë të KQV, vëzhgues të subjekteve zgjedhore</i>	24
<i>Votimi familjar</i>	25
<i>Fotografimi i votës dhe përdorimi i telefonit</i>	25
<i>Respektimi i protokollit COVID-19</i>	25
<i>Ndërhyrje e oficerëve të policisë</i>	26
<i>Ofrimi i asistimit në votim</i>	26
<i>Pengesa në ushtrimin e detyrës së vëzhguesit</i>	26
<i>Mbyllja e procesit të votimit</i>	27
<i>Procesi i votimit në I.E.V.P</i>	27
<i>Të tjera</i>	27
6. PROCESI I NUMËRIMIT	29



1. HYRJJE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (*në vijim "KShH"*) është organizatë jofitimprurëse e themeluar më 16 dhjetor të vitit 1990. Misioni i KShH-së është të kontribuojë në respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit ligjor, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

Ushtrimi i së drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur është e drejtë themelore, e sanksionuar në Kushtetutë. Në këtë këndvështrim, KShH i vlerëson zgjedhjet periodike si ngjarje të rëndësishme. Për këtë arsye, KShH është angazhuar vazhdimisht në monitorimin të zgjedhjeve prej vitit 1996, duke e shtrirë monitorimin përtej procesit të votimit dhe numërimit të votave. Përgjatë monitorimit, KShH u përqëndrua në çështjet lidhur me publikimin e listave zgjedhore, njoftimit me shkrim të zgjedhësve, vendimarrjen e organeve të KQZ (*në vijim "KQZ"*), ngritjen dhe funksionimin e administratës zgjedhore, përkatësisht Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (*në vijim "KZAZ"*) dhe Komisionet e Qendrave të Votimit (*në vijim "KQV"*), mbarëvajtjen e fushatës zgjedhore dhe ndalimit të përdorimit të burimeve shtetërore. Monitorimi ynë ka synuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe përgjegjshmërisë së institucioneve përkatëse lidhur me garantimin e integritetit të procesit zgjedhor.

KShH monitoroi procesin zgjedhor të Zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25 prill 2021. KShH është vënë në lëvizje menjëherë pas dekretimit të zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës¹. Monitorimi i KShH-së mbuloi periudhën parazgjedhore dhe procesin e votimit dhe numërimit të votave. Për shkak të rrethanave në të cilat u zhvillua procesi zgjedhor, sidomos duke patur parasysh masat e marra në përgjigje ndaj pandemisë globale Covid-19, duhet theksuar se monitorimi i procesit zgjedhor, në tërësinë e tij, ishte i pjesshëm. Vëzhguesit e KShH mbuluan 324 Qendra Votimi (*në vijim "QV"*), dhe, gjatë procesit të numërimit të votave, mbuluan 12 Vende të Numërimit të Votave (*në vijim "VNV"*)

KShH akreditoi në KQZ 20 vëzhgues afatgjatë dhe 135 vëzhgues afatshkurtër. Monitorimi i Zgjedhjeve për Kuvend u zhvillua në 9 bashki të Shqipërisë, përkatësisht në Tiranë, Shkodër, Durrës, Kukës, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë.

¹ Dekret Nr. 11700, datë 06.09.2020 "Për caktimin e datës së Zgjedhjeve për Kuvendin"



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSTITUTE FOR STUDIES IN POLITICS
INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES
www.isp.com.al



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

Vëzhguesit e KShH u udhëzuan dhe trajnuan paraprakisht mbi metodologjinë e zhvillimit të monitorimit dhe mbi hapat për t'u ndërmarrë në funksion në këtë proces. Gjithashtu, vëzhguesit u njohën me dispozitat e Kodit Zgjedhor, përfshirë ndryshimet e pësuara si pasojë e reformës zgjedhore, dhe udhëzimet e KQZ-së.

KShH falenderon dhe i është mirënjohës të gjithë vëzhguesve dhe korrespondentëve vendorë për profesionalizmin, integritetin dhe përkushtimin e tyre.

Monitorimi u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian nëpërmjet projektit “Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen”.



2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i ristrukturuar sipas ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, u ballafaqua me një volum të lartë pune, kryesisht për shkak të ngritjes relativisht të vonë të organeve të tij, specifikisht Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Përgjatë veprimtarisë së KQZ-së, kryesisht të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vlerësohet se parimi i transparencës është garantuar. Gjithashtu, është evidentuar mungesa e kohës së nevojshme për konsultim efektiv të projekt-akteve të ndryshme me grupet e interesit dhe shoqërinë civile.

2. Vendimmarrje të caktuara në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, sidomos në vendimet lidhur me përcaktimin e fletës së votimit apo regjistrimin e listës shumëëmërore të kandidatëve për deputet, vihet re një ndarje e ngushtë e anëtarëve (3 me 2), e cila është tregues i mundshëm se këto vendimmarrje mund të jenë marrë nën ndikimin e faktorëve politikë. Sipas raporteve të OSBE/ODIHR² vendimmarrja e ngushtë sipas linjave politike shfaq natyrën e politizuar të diskutimeve të KQZ-së.

3. KShH ka reaguar publikisht ndaj nenit 67, pika 3 të Kodit Zgjedhor, i cili u njëjto kryetarëve/eve të subjekteve zgjedhore të drejtën për të kandiduar deri në katër zona zgjedhore. KShH vlerëson se kjo dispozitë se cënon trajtimin e barabartë të kandidatëve, mbështetur në traktatet dhe standartet ndërkombëtare. Nga monitorimi i kryer në listat shumëëmërore të kandidatëve për deputet, rezulton se kryetarët/et e 7 subjekteve zgjedhore kanë ushtruar mundësinë e kandidimit në më shumë se një zonë zgjedhore.

4. Në fillim të vitit 2021, KQZ miratoi programin e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve. KShH ka vlerësuar se ky proces duhej të kishte nisur zbatimin më herët për shkak të rëndësisë së ndërgjegjësimit në kohë të zgjedhësve mbi kontrollin e listave të zgjedhësve, të dhënave të tyre dhe njohjes paraprake me fletën e votimit në mënyrë që të adresoheshin paqartësitë e zgjedhësve.

5. Listat e përbërësve zgjedhorë janë reflektuar në përputhje me parashikimet e nenit 51 pika 4 të Kodit Zgjedhor, pranë zyrave të gjendjes civile ose në ambientet e Njësisë Administrative. Megjithatë, qytetarët nuk kishin aksesueshmëri të plotë ndaj listave zgjedhore, për shkak të kufizimeve pas orarit zyrtar të institucioneve, në godinat e të cilëve ishin afishuar listat. Gjithashtu, në Njësitë Administrative nr. 3

² Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore, 21 Qershor 2015, OSBE/ODIHR, 8 shtator 2015, Varshavë, fq 7



dhe nr. 4, në Tiranë, disa prej listave zgjedhore kishin të regjistruar rreth 200 zgjedhës, në kundërshtim me përcaktimin e nenit 46 të Kodit Zgjedhor për të patur minimum 300 zgjedhës/listë.

6. Njoftimi me shkrim i zgjedhësve sipas nenit 52 të Kodit Zgjedhor, mbetet një sfidë për administratën e njësive të qeverisjes vendore, e cila nuk është përmbushur, pavarësisht afatit ligjor dhe alokimit të fondit përkatës nga Ministria e Brendshme.

7. Procesi i votimit për shtetasit shqiptarë që kanë vendbanim të përhershëm jashtë vendit nuk u bë funksional në Zgjedhjet për Kuvend të 25 prillit, për shkak të kohës së pamjaftueshme, mangësive të legjislacionit dhe probleme të infrastrukturës, si mungesa e të dhënave në Regjistrin e Gjendjes Civile të adresave të shtetasve shqiptar jashtë vendit, një kriter thelbësor për të mundësuar realizimin e ushtrimit të së drejtës së votës sipas Kodit Zgjedhor.

8. Vendimi për ngritjen e KZAZ-ve u mor në përputhje me afatet ligjore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor (*90 ditë para datës së zgjedhjeve*). Nga 22 Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor të monitoruara, rezultoi se veprimtaria e disa KZAZ-ve në Bashkinë Elbasan filloi në muajin shkurt 2021, tej afateve të parashikuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Selitë e KZAZ-ve objekt monitorimi gjendeshin të vendosura në ambiente publike. Kryerja e veprimtarisë së KZAZ nr. 84, Bashkia Vlorë, në mjediset e zyrës së nën/kryetarit të Bashkisë Vlorë deri më datë 5 mars 2021, vlerësohet shqetësuese. Janë vënë re mungesa të pranishmërisë së anëtarëve të disa KZAZ-ve, pavarësisht caktimit të orarit zyrtar për funksionimin e KZAZ-ve³. Duke qenë se disa prej anëtarëve ishin funksionarë publikë dhe ishin autorizuar për t'u angazhuar në KZAZ, mosprania e anëtarëve ngre dyshim për shpërdorim të burimeve njerëzore gjatë procesit zgjedhor. Në KZAZ nr. 80, Bashkia Gjirokastrë, një anëtarë është raportuar se nuk përmbushte kushtin e të paturit arsimit të lartë, kusht i parashikuar në nenin 31 të Kodit Zgjedhor. Anëtarët e KZAZ-ve u trajnuan përafërsisht 2 muaj me vonë nga data kur duhej të ishin ngritur dhe mbledhur.

9. Procesi i ngritjes së KQV-ve ndeshi në vonesa për shkak të dorëzimit të vonë në KZAZ të propozimeve për anëtarë/sekretarë (*jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve*), dhe vonesave të KZAZ-ve për të marrë vendim përfundimtar (*jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve*). Për shkak të përfshirjes së platformës online të raportimit nga ana e anëtarëve të KQV-ve dhe përdorimi i kamerave e identifikuesve biometrikë, KShH vlerëson se trajnimet e anëtarëve të KQV, të

³ Orari i KZAZ-ve 09.00 - 13.00 dhe 16.00 - 20.00.



zhvilluara në datat 18-23 prill ishin të vonuara. Pjesëmarrja në këto trajnime ishte e ulët në disa prej Bashkive të monitoruara.

10. Veprimtaritë e subjekteve zgjedhore me karakter electoral filluan para afatit të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor të fillimit të fushatës zgjedhore (*një muaj para datës së zgjedhjeve*). U evidentuan organizime të takimeve informale në ambiente të mbyllura dhe në kundërshtim të protokolleve për parandalimin e Covid-19. Ndërkohë, në Bashkitë Tiranë dhe Durrës, u evidentuan “*veprimtari të ndaluara për t’u promovuar*” në kundërshtim me nenin 3, pika 1, të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator, gjatë periudhës kohore 4 muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. Gjatë fushatës zgjedhore, një ndër problematikat e hasura ishte përfshirja e punonjësve të administratës publike gjatë orarit zyrtar të punës në mbledhjet apo takimet e subjekteve zgjedhore në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor.

11. KShH konstatoi së Bashkia Tiranë, Korçë, Elbasan dhe Durrës nuk respektoi detyrimin ligjor për publikimin e vendimmarrjes për caktimin e vendeve të afishimit të materialeve propagandistike në kundërshtim me nenin 79 të Kodit Zgjedhor. Në Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Gjirokastrë pati shkelje të vendimit nr. 6, datë 23/03/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ku janë afishuar materiale propagandistike të subjekteve zgjedhore në fasadat e institucioneve publike, përkatësisht në fasadën e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Pallatit të Sportit në Gjirokastrë.

12. Zyrat zgjedhore në Bashkitë Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër dhe Elbasan u ngritën para afatit ligjor të fushatës zgjedhore dhe përmbanin elementë të fushatës si logot, posterat dhe motot e subjekteve zgjedhore në kundërshtim me nenin 79 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet afishimi i materialeve propagandistike pranë zyrave zgjedhore vetëm përgjatë fushatës zgjedhore (*duke filluar nga data 26 mars*).

13. Gjatë procesit të votimit, u evidentuan raste të shumta të pezullimit të procesit të votimit për shkak të problemeve me funksionimin e pajisjes PEI. Për rrjedhojë, procesi i identifikimit të zgjedhësve u operua në menyrë manuale, duke verifikuar letërnjoftimin e paraqitur me anë të listave të zgjedhësve. Kjo solli si pasojë mungesën e praktikës së unifikuar të KQV, të cilat përdorën listën e zgjedhësve, përpos identifikimit nëpërmjet pajisjes PEI, ose vetëm nëpërmjet pajisjes PEI.

14. Përgjatë procesit të votimit, KShH-në u sinjalizua lidhur me praninë e personave të paautorizuar të cilët orientonin apo shoqëronin zgjedhësit për në qendrat e



votimit⁴. Anëtarët e KQV-veë rrallëherë morën masa për largimin e personave të paaautorizuar nga ambjentet e QV-së, nëpërmjet njoftimit të oficerëve të policisë.

15. Në kuadër të parimit të fshehtësisë së votës dhe respektimit të parimit se vota është e lirë, u raportuan raste të votuesve të cilët u shoqëruan dhe u asistuan në dhomën e fshehtësisë nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore apo anëtarët e KQZ. Gjithashtu, u evidentuan praktika të cënimit të fshehtësisë së votës pasi anëtarët e KQV deklarorin me zë të lartë numrin rendor të zgjedhësve, i cili mbahej shënim nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore.

16. Vëzhguesit e KShH raportuan raste të votimit familjar në disa Bashki⁵. Në QV 2374, Bashkia Elbasan, u parandalua tentativa për votim familjar nëpërmjet depozitimit të vërejtjes me shkrim nga vëzhguesi i KShH-së.

17. Gjatë zgjedhjeve të 25 prillit 2021 pati vëmëndje të shtuar ndaj fotografimit të votës, cka përbën veprë penale, dhe përdorimit të telefonit gjatë procesit të votimit. KShH u sinjalizua për tentativa të fotografimit të votës⁶ apo përdorimit të telefonit⁷.

18. Instituti i Shëndetit Publik dhe KQZ publikuan protokollin për parandalimin e përhapjes së Covid-19 gjatë procesit të votimit. Në kundërshtim me parashikimin e protokollit se QV-të duhen vendosur në katin e parë të godinës, u raportuan raste ku QV-të u vendosën në katin e dytë⁸. Gjithashtu, vëzhguesit sinjalizuan rregullisht se masat ndaj Covid-19 (*mbajtja e maskës, distancimi*) nuk u zbatuan në mënyrë të përgjegjshme dhe rigoroze⁹.

19. Përgjithësisht, vëzhguesit e KShH-së ushtruan funksionin e tyre lirisht. Por, u raportuan raste të intimidimit, kërcënimit apo pengimit.

20. Në shumicën e QV-ve të monitoruara, procedura e mbylljes së procesit të votimit u zhvillua normalisht, në përputhje me parashikimet ligjore të mbylljes së QV-së në orën 19.00. Në disa QV pati vonesa deri në 1 orë për shkak të votuesit në rradhë dhe

⁴ QV 255/1, 259 Bashkia Shkodër, QV 1844 Bashkia Tiranë, QV 3026/1 Bashkia Fier, QV 43131 Bashkia Gjirokastër,

⁵ QV 1411/2, 1489/1, 1449/2, Bashkia Durrës, QV 4235 Bashkia Gjirokastër, QV 1724 Bashkia Tiranë, QV 364/1 Bashkia Korçë, QV 0255/1, 260 Bashkia Shkodër

⁶ QV 3026, Bashkia Fier

⁷ QV 1468/1, 1470/1, 1429 Bashkia Durrës, QV 3696/1, 3664/1 Bashkia Korçë, QV 1887/1 Bashkia Tiranë

⁸ QV 0648, Bashkia Kukës

⁹ QV 0255, QV 0256, QV 0316/1 Bashkia Shkodër; QV 3656, Bashkia Korçë; QV 1886, Bashkia Tiranë, QV 1489/1 Bashkia Durrës, QV 4507/1 Bashkia Vlorë, QV 3028/1 Bashkia Fier,



vonesave në mbylljen e procedurave të mbylljes së votimit¹⁰. Materialet zgjedhore u nisën rregullisht për në VNV, shoqeruar nga sekretari, anetarë dhe oficer policie.

21. Vëzhguesit e KShH u angazhuan në monitorimin e dy qendrave të posacme të votimit në I.E.V.P Drenovë (QV 3707/1) dhe në I.E.V.P Durrës (QV 14222). Është raportuar se, përgjithësisht, zgjedhësve në këto QV nuk u ishte ofruar informacion për mënyrën dhe rregullat e reja të votimit.

22. Parashikimi ligjor për mbërritjen në VNV të kutive të votimit të të gjitha QV-ve në juridiksionin e KZAZ-së brenda 3 orëve prej mbylljes së votimit, përgjithësisht, nuk u zbatua¹¹.

23. Anëtarët e GNV-ve shfaqën mosnjohje të procesit, çka mbështet nevojën për të zhvilluar trajnimet e anëtarëve të administrates zgjedhore në kohë.

24. Procesi i numërimit të votave u ndesh në zvarritje të herëpashershme, pavarësisht thirrjeve të KQZ-së për përsheptim dhe mosndërprerje të panevojshme të procesit.

25. Ndërhyrjet e vazhdueshme të personave të pranishëm në ambientet e VNV-ve cenojnë zhvillimin e qetë të procesit të numërimit dhe krijojnë trysni ndaj numëruesve, vendimet e të cilëve kritikoheshin haptazi nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, paçka se kjo e drejtë nuk i njihet.

26. Monitorimi i procesit të numërimit ka sinjalizuar një numër të lartë të fletëve të votimit të cilësuar të pavlefshme nga anëtarët e GNV-ve. Implementimi për herë të parë i votimit preferencial për kandidatët/et dhe shtrirja e pamjaftueshme në kohë e fushatës së informimit lidhur me modelin e fletës së votimit krijuan premisa për të patur një numër të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Për shkak të paqartësive lidhur me mënyrën e votimit, shumë zgjedhës kanë votuar në mënyrë të atillë që sillte për pasojë pavlefshërinë e fletës së votimit.

10 QV 3016 Bashkia Fier (19.50); QV 260 (20.03), QV 259/1 (19.40), QV 259 (19.36) Bashkia Shkodër, QV 4440 Bashkia Vlorë (19.35), QV 0633 (20.01), QV 0648, QV 0649 (19.47) Bashkia Kukës

11 KZAZ nr. 2 Bashkia Shkodër, KZAZ nr.30, 39 Bashkia Tiranë, KZAZ nr 21, nr. 24 Bashkia Durrës, KZAZ nr. 84 Bashkia Vlorë, KZAZ nr. 48 Bashkia Elbasan, KZAZ nr. 80 Bashkia Gjirokastrë,



3. PROCESI PARAZGJEDHOR

Publikimi i listave zgjedhore dhe njoftimi me shkrim i zgjedhësve

Hallka fillestare e procesit parazgjedhor është publikimi i rregullt dhe periodik i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10 019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 101/2020 (në vijim “Kodi Zgjedhor”).

Verifikimi i zbatimit të dispozitës së sipërcituar u krye në 11 Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë, ku rezultoi se ekstraktet e para të përbërësve zgjedhorë (*listat e zgjedhësve*) ishin publikuar në periudhën 5-6 tetor 2020, duke qënë kështu në përputhje me përcaktimin ligjor të publikimit jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve¹², e cila përkon me datën 6 tetor 2020.

Si pasojë e ndryshimeve të pësuara në Kodin Zgjedhor, *një zonë qendre votimi ka jo më pak se 300 dhe jo më shumë se 1000 zgjedhës me vendbanim në territorin e saj*¹³. Monitorimi i kryer nga vëzhguesit e KShH evidentoi se përgjithësisht ky detyrim u respektua në publikimin e listave zgjedhore, me përjashtim të listave të publikuara në Njësitë Administrative nr. 3 dhe nr. 4, ku prej verifikimit në terren rezultoi të kishte lista zgjedhore me përafërsisht 200 zgjedhës të regjistruar. Për sa i përket listave të publikuara në ambientet e brendshme të zyrave të gjendjeve civile, aksesit i qytetarëve ndaj listave rezultoi të jetë i kufizuar pasi ambientet ishin të aksesueshme vetëm gjatë orarit zyrtar të punës, duke përjashtuar kështu edhe fundjavën.

Në Kodin Zgjedhor të ndryshuar u miratuan 3 dispozita të reja që garantonin pjesëmarrjen në zgjedhje dhe të shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor prezantuan mundësinë e votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë¹⁴. Vëzhgimet tona në njësitë e Bashkisë Tiranë vërtetuan se në regjistrat e Gjendjes Civile nuk figuronin adresat e përhershme të shtetasve shqiptarë, kërkesë kjo e Kodit Zgjedhor. Për këtë u vu në dijeni edhe KQZ-ja, e cila pas disa verifikimeve arriti në përfundimin se për zgjedhjet e 25 Prillit 2021 nuk ishte i mundur zbatimi i këtyre dispozitave.

¹² Neni 51, pika 4 e Kodit Zgjedhor

¹³ Neni 46, pika 2 e Kodit Zgjedhor

¹⁴ Neni 24 i Kodit Zgjedhor



Gjithashtu, u monitorua lidhur me zbatimin e detyrimit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve nga ana e institucioneve vendore¹⁵. Sipas përgjigjeve të marra nga institucionet vendore¹⁶, njoftimi me shkrim i zgjedhësve nuk rezulton të jetë përfunduar, pavarësisht tejkalimit të afatit ligjor dhe shpërndarjes së fondit përkatës nga Ministria e Punëve të Brendshme¹⁷. Njoftimi me shkrim i zgjedhësve në banesat e tyre do lehtësonte njohjen e tyre me të dhënat përkatëse, sidomos duke patur parasysh se aksesimi dhe konsultimi fizikisht i listave zgjedhore dhe ndërveprimi me institucionet shtetërore ishte i kufizuar për shkak të masave të marra ndaj pandemisë Covid-19.

Në vijim të shpalljes së listave përfundimtare të zgjedhësve (*40 ditë para datës së zgjedhjeve*), monitorimi gjatë muajit prill u përqëndrua në publikimin e listave zgjedhore në QV. Përgjithësisht, janë respektuar afatet ligjore të shpalljes së listave zgjedhore përfundimtare. Por në disa raste, u evidentuan parregullsi ose mospërshtatshmëri në publikimin e listave. U konstatua në QV-në të shkollës 9-vjeçare “*Ahmet Gashi*”, pjesë e KZAZ nr. 41, se listat zgjedhore u afishuan në ambientet e jashme të shkollës, të ndikuara nga kushtet atmosferike, duke pësuar kështu grisje dhe dëmtim. Aksesimi i qytetarëve është penguar gjithashtu nga fakti se dyert e institucioneve ku ishin shpallur listat qendronin të mbyllura pas orarit të mësimi/punës¹⁸. Gjithashtu, një pjesë e listave ishin të afishuara brenda dritareve të klasave të katit të parë të shkollave përkatëse, të cilat, ndërkohë që i mbrojnë listat nga kushtet atmosferike, gjithashtu i bëjnë ato jo lehtësisht të lexueshme nga ana e qytetarëve, për shkak të pozicionimit të tyre¹⁹.

Veprimtaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

KShH ishte i angazhuar në vëzhgimin dhe monitorimin në baza mujore të veprimtarisë së KQZ-së dhe organeve përbërëse²⁰. Kodi Zgjedhor parashikoi një strukturë të re organike të KQZ-së, duke shpërndarë vendimmarrjen në tre organe të ndryshme. Vlen të theksohet se organet e KQZ-së kanë vepruar dhe ushtruar kompetencat e tyre në afate tepër të kufizuara kohore, për shkak të formimit dhe

¹⁵ Neni 52, pika 1 e Kodit Zgjedhor

¹⁶ Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Shkodër, Bashkia Elbasan, Bashkia Kukës, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Vlorë, Bashkia Fier, Bashkia Korçë

¹⁷ Neni 52, pika 5 e Kodit Zgjedhor

¹⁸ Shkolla 9-vjeçare “*Avni Rustemi*”; shkolla 9-vjeçare “*Kongresi i Pezës*”; KZAZ nr .59 në Bashkinë Fier; QV e pozicionuar në Kopshtin “*Soros*”, Bashkia Korçë

¹⁹ QV të shkollës “*Ismail Qemali*” në Bashkinë Shkodër

²⁰ Komisioni Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve



emërimit me vonesë të anëtarëve të organeve të KQZ-së. Bashkë me ndërlikimet e pashmangshme të pandemisë globale Covid-19, e vendosën KQZ-në në kushte të pafavorshme. Ama, vlerësohet se KQZ, veçanërisht organi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ka vepruar dhe ushtruar kompetencat me profesionalizëm, ka garantuar parimin e konsultimit publik dhe gjithëpërfshirës, sidomos me shoqërinë civile, dhe ka shënuar progres të dukshëm përsa i përket garantimit të parimit të transparencës.

Në fillim të vitit 2021, KQZ miratoi programin e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve. KShH vlerësoi se ky proces duhej të kishte nisur zbatimin më herët për shkak të rëndësisë së ndërgjegjësimit në kohë të zgjedhësve mbi kontrollin e listave të zgjedhësve, të dhënave të tyre dhe njohjes paraprake më fletën e votimit në mënyrë që të adresoheshin paqartësitë e zgjedhësve.

KShH vëren se në kuadër të rrethanave të pazakonta në të cilat u zhvillua procesi zgjedhor për shkak të kufizimeve si pasojë e pandemisë globale Covid-19, nevojitej interpretim i saktë i fushëveprimit të vëzhgimit mediatik nga ana e KQZ-së në mënyrë që të kishte vëmendje dhe ndaj përmbajtjes së mediave alternative, përfshirë platformat e mediave sociale, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare dhe rekomandimet e marra nga OSBE/ODIHR, i cili në vëzhgimin e zgjedhjeve të fundit për Kuvend përfshiu median sociale në fushëveprimin e vëzhgimit të medias²¹.

Në kuadër të konsolidimit të kapaciteteve të administratës zgjedhore, KShH risjell në vëmendje rekomandimin e mëhershëm të OSBE/ODIHR²² lidhur me krijimin e një rrjeti personash të trajnuar mbi legjislacionin zgjedhor, i cili do të shërbente për t'iu përgjigjur nevojave emergjente për zëvendësimin e anëtarëve të KQV-ve. Po ashtu edhe trajnimi në kohë të punonjësve të administratës zgjedhore ishte më i nevojshëm për shkak të zbatimit të teknologjisë së informacionit dhe sistemit të video-regjistrimit dhe përgatitjes së anëtarëve të KQV-ve për zbatimin e rregullave për administrimin e pajisjeve teknologjike.

Lidhur me vendimmarrje të caktuara në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, u vu re një ndarje e ngushtë e anëtarëve (3 me 2), e cila mund të jetë një tregues i mundshëm se këto vendimmarrje mund të jenë marrë nën ndikimin e faktorëve

²¹ OSCE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin, 28.09.2017, Varshavë, fq. 18.

²² Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin 25 Qershor 2017, OSBE/ODIHR, 28 shtator 2017, Varshavë, fq 27.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES
www.isp.com.al



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

politikë. Sipas raporteve të mëparshme të OSBE/ODIHR²³, vendimarrja e ngushtë sipas linjave politike shfaq natyrën e politizuar të diskutimeve të KQZ-së (*referuar strukturës së mëparshme të institucionit*).

KShH ka reuar publikisht ndaj përmbajtjes së nenit 67, pika 3 të Kodit Zgjedhor, për shkak se cënon trajtimin e barabartë të kandidatëve, mbështetur në traktatet dhe standartet ndërkombëtare. Gjithashtu, Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR, në opinionin e përbashkët mbi ndryshimet e Kodit Zgjedhor të datës 5/10/2020, rekomanduan se udhëheqësit politikë duhet të angazhoheshin që të vetëpërbahen nga kandidimi në disa zona elektorale dhe që kjo dispozitë duhet të rishikohet pas zgjedhjeve parlamentare 2021. Duke iu referuar listave shumë-emërore të subjekteve zgjedhore paraqitur në KQZ rezulton se kryetarët e 7 subjekteve zgjedhore²⁴ ushtruan mundësinë e kandidimit në më shumë se një zonë zgjedhore.

Ngritja dhe funksionimi i Komisioneve e Zonave të Administrimit Zgjedhor

KShH gjithashtu ndërmori monitorimin e veprimtarisë të 22 KZAZ²⁵. Në vijim të vendimmarrjes së organeve të KQZ-së, specifikisht Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve²⁶ dhe Komisionit Rregullator²⁷, lidhur me ngritjen dhe përcaktimin e organizimit të KZAZ-ve, KShH hulumtoi rreth procesit së ngritjes së këtyre strukturave, administrimit të këtij procesi dhe mbarëvajtjes së veprimtarisë së KZAZ-ve. Të dhënat dhe gjetjet e kësaj faze të monitorimi shtrihen në periudhën shkurt-prill 2021.

²³ Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore, 21 Qershor 2015, OSBE/ODIHR, 8 shtator 2015, Varshavë, fq 7 “*natyra e politizuar e diskutimeve të KQZ-së u vu re në shumicën e mbledhjeve të saj. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vuri re se, ndërkohë që vendimet mbi çështjet teknike u miratuan shpesh me unanimitet, vendimet mbi çështje më thelbësore u miratuan kryesisht me votim të ndarë katër me tre*”

²⁴ Partia Balli Kombëtar; Partia Socialiste e Shqipërisë; Partia Nisma Thurje; Partia Lëvizja për Ndryshim; Partia Lëvizja Socialiste për Integrim; Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare; Partia Socialdemokrate

²⁵ 9 KZAZ në Tiranë, 3 në Durrës, 3 në Shkodër, 2 në Elbasan, 4 në Vlorë, 3 në Gjirokastrë, 2 në Korçë

²⁶ Vendim nr. 15, datë 25.01.2021 “*Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021*”; Vendim nr. 14, datë 25.01.2021 “*Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021*”; Vendim nr. 22, datë 02.02.2021 “*Për emërimin e kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor*”

²⁷ Vendim nr. 05, datë 20.11.2020, “*Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor*”



Për sa i përket emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, partia më e madhe e shumicës propozoi 91 gra dhe 139 burra, pra respektivisht 39.56% dhe 60.44%. Ndërsa partia më e madhe e opozitës propozoi 69 gra dhe 161 burra, respektivisht 30% dhe 70%. Vërehet se të dyja partitë ishin në përputhje të dispozitës ligjore që kërkon 30% të anëtarëve të propozuar të jenë nga secila gjini. Ama, duke patur parasysh që dispozita ligjore vendos vetëm një dyshe me të përfaqësimit të barabartë gjinor në 30%, subjektet politike duhen nxitur për të garantuar një barazi gjinore më të qënësishme në procesin zgjedhor.

KZAZ-të e monitoruara i kishin selitë e ngritura në mjedise publike²⁸. Problematike u shfaq ndarja e mjediseve dhe ndërveprimi me administratën e institucioneve arsimore/kulturore ku zhvillojnë veprimtarinë, amortizimi i disa godinave dhe hapësira e pamjaftueshme në kuadër të respektimit efektiv të masave ndaj pandemisë Covid-19. Vëzhguesit afatgjatë raportuan se KZAZ nr. 84 në Bashkinë Vlorë zhvilloi veprimtarinë në mjediset e zyrës së nën/kryetarit të Bashkisë Vlorë deri në datën 5/03/2021, Në vijim, selia u vendos në mjediset e Pallatit të Kulturës “Labëria”. Kryerja e veprimtarisë së administratës zgjedhore në mjediset e administratës lokale bie në kundërshtim me nenin 93, pika 2, të Kodit Zgjedhor, i cili nuk lejon krijimin e selive të KZAZ-ve në ndërtesa që përdoren nga administrata publike.

KZAZ-të e monitoruara kishin numër të plotë të anëtarësisë. U raportua se në KZAZ nr. 38 dhe nr. 40 në Tiranë, disa anëtarë të KZAZ-së nuk morën pjesë në mbledhjet e para të zhvilluara dhe nuk vendosën kontakt me anëtarët e tjerë. Në vlerësimin e KSHH-së, kjo çështje duhet të ishte mbikqyrur në mënyrë më rigoroze nga KQZ.

Është pozitiv fakti se vakancat e krijuara në momentin e ngritjes së KZAZ-ve, si pasojë e mungesës së propozimit nga subjekti zgjedhor u adresuan nga KQZ në përputhje me procedurën ligjore të nenit 29 të Kodit Zgjedhor, i cili shprehet se në rastin se një parti politike nuk ushtron të drejtën për të propozuar anëtarë të KZAZ-

²⁸ Tiranë: KZAZ nr.38 (Shkolla e Kuqe), nr.39 (Muzeu Historik Kombëtar), nr.40 (Shkolla “Qemal Stafa”)

Shkodër: KZAZ nr.2 (Pallati i Sportit “Qazim Dervishi”), nr.3 (Shkolla e Mesme “Arben Broci”), nr.4 (Shkolla publike “Azem Hajdari”)

Durrës: KZAZ nr.21, (Shkolla 9-vjecare “Njazi Mastori”), nr. 22 (Pallati i Sportit “Ramazan Jala”), nr.23 (Shkolla 9-vjecare “Marie Kaculini”), nr.24 (Shkolla e Mesme “Leonik Tomeo”)

Elbasan: KZAZ nr.45 (Qendra e Kulturës), nr. 47, nr. 48 (Pallati i Sportit “Tomorr Sinani”)

Vlorë: KZAZ nr. 83 (Shkolla “Ismail Qemali”), nr.84, (Pallati i Kulturës “Labëria”), nr. 85 (Shkolla “Ali Demi”), nr.86 (Pallati i Sportit “Flamurtari”)



ve, kjo e drejtë i njihet partisë së rradhës brenda të njejtit grupim²⁹. Ashtu si në zgjedhjet e kaluara, ka patur zëvendësime të anëtarëve të KZAZ-ve, me kërkesë të subjekteve zgjedhore³⁰.

U evidentua se në disa Bashki³¹ pati vonesa në marrjen e bazës materiale nga KQZ. Në rastin e KZAZ nr.38 në Tiranë, rezulton se nuk u pajisën me linjë telefonike të rrjetit fikse apo shërbim internet deri në datën 1/03/2021, sipas kërkesës së pikës 3, të nenit 16 të vendimit nr. 05 të Komisionit Rregullator.

Reflektimi i shenjave dalluese të KZAZ-ve dhe afishimi i informacionit të nevojshëm, sipas vendimit të Komisionit Rregullator nr. 05, datë 20.11.2020 u krye pjesërisht, për shkak të mospajisjes me adresë email nga KQZ (KZAZ nr. 40 Tiranë), vonesave në marrjen në dorëzim të bazës materiale (KZAZ nr. 2 Shkodër), mosrealizimit të plotë të të dhënave nga anëtarësia e KZAZ (lista e anëtarëve, të dhënat e kontaktit) (KZAZ-të nr. 22, 23 në Durrës, KZAZ-të nr. 47, 49 në Elbasan).

Anëtarët e KZAZ-ve shprehën gjatë monitorimit të parë, në periudhën shkurt-mars, se ende nuk kishin marrë trajnim nga KQZ-ja lidhur me forcimin e kapaciteteve profesionale, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë së KZAZ-ve. Në vlerësimin e KShH-së dhe nisur nga përvojat e mëparshme të procesit zgjedhor, trajnimi i menjëhershëm i anëtarëve të KZAZ-ve, sapo ato ngrihen, është element i rëndësishëm i mbarëvajtjes me cilësi dhe profesionalizëm i procesit të administrimit zgjedhor prej tyre. Nga monitorimi i kryer gjatë prillit 2021, rezulton se anëtarët e KZAZ-ve janë trajnuar në datën 22 mars, në një trajnim i cili ka zgjatur 1 ditë dhe më pas është finalizuar me një testim të njohurive.

Nëpërmjet monitorimit të kryer në 22 KZAZ, rezulton se zgjedhësit nuk kanë ushtruar të drejtën e shprehur në nenin 34, shkronja g) të Kodit Zgjedhor për të depozituar kërkesa apo ankesa përsa i përket përditësimit apo saktësimit të të dhënave në listat zgjedhore.

Ngritja dhe funksionimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit

29 Vendim i Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet nr. 49, datë 11.02.2021 “Për emërimin e anëtarëve të disa KZAZ-ve, lirim dhe emërim të disa anëtarëve në KZAZ nr. 72, Qarku Korçë, KZAZ nr. 77, KZAZ nr. 81, KZAZ nr. 82, Qarku Gjirokastrë, dhe të sekretarit të KZAZ-së nr. 82, Qarku Korçë”.

30 Konstatuar në KZAZ nr. 45 Elbasan dhe KZAZ nr. 81, 82 Gjirokastrë

31 KZAZ nr. 2 në Shkodër dhe KZAZ nr. 73 në Korçë



Gjatë muajit prill 2021, KShH realizoi monitorimin e procesit të ngritjes dhe funksionimit të KQV-ve në 9 bashki të vendit. Në aspektin metodologjik, grumbullimi i të dhënave cilësore dhe statistikore u realizua mbi bazën e pyetësorit të përgatitur nga KShH, në formën e bashkëbisedimit me kryetarët, sekretarët ose zv/kryetarët, si dhe monitorimit periodik të veprimtarisë së KQZ-së. Gjatë monitorimeve të realizuara, në pjesën më të madhe të KZAZ-ve, vëzhguesve të KShH-së nuk i është kufizuar aksesit, me përjashtim të aksesit në dokumentacion dhe materiale nga KZAZ nr. 35 në Bashkinë e Tiranës.

KQV janë njësitë e administratës zgjedhore të cilat përgjigjen për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit, sipas detyrave dhe kompetencave të parashikuara në Kodin Zgjedhor. Procesi i ngritjes së KQV-ve shfaqti vonesa në disa KZAZ³², si pasojë e dorëzimit nga subjektet zgjedhore të propozimeve për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor³³ (jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve) dhe nenit 9 të Vendimit nr. 11/2021 të Komisionit Rregullator. Pavarësisht se në shumicën e KZAZ-ve propozimet u dorëzuan brenda afatit ligjor, praktika e ngritjes së vonë të KQV-ve nuk lejon hapësirën e mjaftueshme për të garantuar mbarëvajtjen e qetë të trajnimeve të anëtarëve apo kryerjen e funksioneve të tjera të KQV-ve. Gjithashtu, u evidentuan raste³⁴ të dorëzimit të paplotë të dokumentacionin mbështetës për kandidatët e propozuar nga subjektet zgjedhore. Për pasojë, solli dhe emërimin me vonesë të anëtarëve/sekretarëve të KQV-ve nga ana e KZAZ-ve³⁵.

Po ashtu u evidentuan vonesa deri në 5 ditë në njoftimin e KQZ lidhur me vendimmarrjen e emërimit të anëtarëve të KQV-ve, duke qënë se neni 9 pika 5 parashikon njoftimin e menjëhershëm të KQZ³⁶. Në vijim të emërimit të anëtarësisë së KQV-ve, u raportuan vendimet e para për zëvendësimin e disa anëtarëve, sipas kërkesave të depozituara nga ana e subjekteve zgjedhore³⁷.

32 KZAZ nr. 39, Bashkia Tiranë; KZAZ nr. 74, Bashkia Korçë

33 Neni 36 i Kodit Zgjedhor: “Anëtarët dhe sekretari i KQV-së emërohen vetëm për periudhën e zgjedhjeve. Propozimet për anëtarë dhe sekretar të KQV-së bëhen jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe në rastin e zgjedhjeve të pjesshme apo të parakohshme 20 ditë para datës së zgjedhjeve. KZAZ-ja emëron anëtarët e KQV-ve jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve, kur konstaton se propozimi është në përputhje me kërkesat e neneve 37 dhe 38 të këtij Kodi. Në çdo rast emërimi i anëtarëve dhe sekretarit bëhet jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve”

34 KZAZ nr. 83, në Bashkia Vlorë; KZAZ nr. 52, Bashkia Elbasan

35 KZAZ nr. 39, Bashkia Tiranë; KZAZ nr. 74, Bashkia Korçë

36 KZAZ nr. 39, Bashkia Tiranë; KZAZ nr. 30, Bashkia Tiranë; KZAZ nr. 2, Bashkia Shkodër

37 KZAZ nr. 23, Bashkia Durrës; KZAZ nr. 11, Bashkia Kukës, KZAZ nr. 80, nr. 82, Bashkia Gjirokastrë



Trajnimet e anëtarëve të KQV-ve u zhvilluan përgjatë datave 18-23 prill, sipas kalendarit të përcaktuar nga KQZ. U raportua se pjesëmarrja e anëtarëve të KQV në këto trajnime ishte relativisht e ulët, pavarësisht zhvillimit të trajnimeve në dy turne për të akomoduar nevojat e anëtarëve të KQV-ve. Për shkak të përfshirjes së platformës *online* të raportimit nga ana e anëtarëve të KQV-ve dhe përdorimi i kamerave e identifikuesve biometrikë, KSHH vlerëson se zhvillimi i trajnimeve ishte i vonuar. Paralelisht me zhvillimin e trajnimeve të organizuara nga KQZ, subjektet zgjedhore raportohet se kanë zhvilluar trajnime të ngjashme të anëtarëve të KQV-ve pranë selive të tyre apo zyrave zgjedhore vendore. Në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor³⁸, administrimi dhe organizimi i trajnimeve të administratës zgjedhore është kompetencë ekskluzive e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, specifikisht Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Vlerësojmë se mbivendosja e panevojshme e trajnimeve sjell paqartësi në punën e anëtarëve të administratës zgjedhore dhe dhënie prioritet këshillave të marra nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, të cilët nuk janë të çertifikuar për t'i ofruar ato.

Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave

Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (*në vijim "GNV"*) në disa raste u shoqërua me problematika dhe vonesa, duke mos respektuar kërkesat e nenit 95 të Kodit Zgjedhor. Nga KZAZ-të e monitoruara rezulton se në KZAZ nr. 35, Bashkia Tiranë, GNV-të nuk ishin ngritur deri me datë 21 prill. Gjithashtu, në Bashkinë Vlorë pati raste ku GNV-të nuk ishin ngritur, konkretisht në KZAZ nr. 84 dhe nr. 86, ku shkak ishte bërë konflikti politik mes subjekteve LSI dhe PDIU, sa i takon emërimin të numëruesit të katërt në përputhje me nenin 96 të Kodit Zgjedhor. Procesi u shoqërua edhe me vonesa të mëtejshme, ku ndër KZAZ-të e monitoruara, KZAZ nr. 83 në Vlorë, dhe KZAZ nr.81 në Gjirokastrë u ngritën përkatësisht një deri në pesë ditë në tëjkalim të afatit ligjor³⁹.

Përcjellja me vonesë e propozimeve të emërimit të anëtarëve të GNV-ve nga subjektet zgjedhore, solli krijimin e grupeve me përbërje të pjesshme⁴⁰. Kështu, në KZAZ nr.81 në Gjirokastrë, propozimet për anëtarë u përcollën pesë ditë me vonesë. U raportua se anëtarët e emëruar kishin arsim të lartë.

38 Neni 19, pika gj) e Kodit Zgjedhor

39 Në KZAZ 83 Vlorë, vendimmarrja për ngritjen e GNV-ve është kryer më 19.04.2021

40 GNV-të janë ngritur me përbërje prej 4 anëtarë, ku në pjesën më të madhe të KZAZ-ve të monitoruara janë respektuar parashikimet e nenit 95 dhe 96 mbi përkatësinë politike të anëtarëve, me përjashtim të KZAZ nr. 84 dhe 86 në Vlorë,



Gjatë monitorimit të GNV-ve, për vëzhguesit e KShH-së ka patur kufizim aksesit në KZAZ nr 35, Tiranë dhe KZAZ nr.48 dhe 50 në Elbasan, anëtarët e të cilave nuk kanë lejuar vëzhguesit të kqyrnin Librin e Protokollit apo vendimet e KZAZ, në çënim të nenit 7 të Kodit Zgjedhor.

Fushata zgjedhore dhe përdorimi i burimeve shtetërore

De facto, fushata zgjedhore filloi para afatit të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor (një muaj para datës së zgjedhjeve). Fushata është perceptuar të jetë realizuar në një klimë tepër të polarizuar politike, si dhe është shoqëruar me elementë të gjuhës së urrejtjes, të diskriminimit gjinor apo në çënim të dinjitetit të kandidatëve. Në deklaratat për shtyp⁴¹, KShH, por edhe partnerët ndërkombëtarë në Shqipëri, drejtuan vazhdimisht thirrje subjekteve zgjedhore për vetëpërbajtje dhe shmangie të gjuhës urrejtjes. KShH theksoi rëndësinë e garantimit të barazisë në ligj dhe para ligjit, për respektimin e masave Covid-19 të lidhura me të drejtën e tubimit dhe grumbullimeve gjatë fushatës zgjedhore nga çdo subjekt zgjedhor.

Nga monitorimi i realizuar, u evidentua organizimi i takimeve informale në ambiente të mbyllura dhe në çënim të protokolleve dhe masave Covid-19 të propozuara nga Komiteti i Teknik i Ekspertëve dhe të miratuara më pas me akte ligjore dhe nënligjore.

Përgjatë periudhës 4 mujore para datës së zgjedhjeve, u raportua ndërmarrja e veprimtarive në kundërshtim me nenin 3, pika 1, gërma a) dhe ç) të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator. Në Bashkinë Tiranë, KShH reagoi publikisht lidhur me deklaratat në media për vendimarrjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës për përjashtimin e bizneseve nga detyrimi për pagesën e tarifës së zënies së hapësirës publike dhe shtyrjen e pagesës së taksave dhe tarifave vendore, për shkak të mundësisë së krijimit të premisave për keqpërdorim të burimeve shtetërore dhe pabarazi në garën elektorale. Konkretisht, kjo veprimtari bie në kundërshtim me nenin 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor ku deri në 4 muaj para datës së zgjedhjeve, ndalohet miratimi i akteve, të cilat favorizojnë apo krijojnë lehtësira për kategori të caktuara të popullsisë. Për këtë rast, KShH ka vënë në dijen dhe KQZ-në.

Gjatë fushatës zgjedhore, një ndër problematikat e hasura ishte përfshirja e punonjësve të autoriteteve të ndryshme të administratës publike në mbledhjet apo

41 https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinkit/posts/3614757971981040?_tn_ =K-R
<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinkit/photos/a.330295387093998/3544042082385963/?type=3&theater>



takimet e subjekteve zgjedhore. Përfshirja dhe shfrytëzimi i administratës dhe burimeve shtetërore për promovimin e subjekteve zgjedhore apo kandidatëve të caktuar është në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor. Kjo dispozitë u shkel nga disa prej subjekteve zgjedhore, ku evidentohen mbledhje me punonjës të autoriteve publike të niveleve të ndryshme. Në Bashkinë Durrës, u raportua se drejtuesit e Njësisë Administrative, Rajoni 4 në Durrës u përfshinë në veprimtari zgjedhore brenda orarit zyrtar të punës⁴². Gjithashtu, kandidatët për deputetë, duke qënë dhe në drejtimin e pushtetit vendor, përfshinë në fushatë punonjës të administratës, qoftë në nivel specialistësh e po ashtu në nivel drejtues.

Nga monitorimi i zhvillimit të fushatës zgjedhore në Bashkinë e Durrësit, u raportua nga vëzhguesit se në datën 14 prill 2021, Bashkia Durrës ka pranuar aplikime individuale për përfitimin e bonusit të qerasë nga qytetarët e dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, proces i rregulluar nga Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për Përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. U raportua se pranimi i aplikimeve për përfitimin e bonusit të qerasë është pezulluar prej muajit dhjetor 2021, ndërkohë që prej datës 14 prill rinisi procesi, në mungesë të njoftimit publik nga ana e Bashkisë Durrës. Sipas qytetarëve të kësaj Bashkie, procesi u administrua në mënyrë të tillë që, krijon selektivitet në dhënien e përfitimit të pagesës së qerasë, duke përmbajtur elementë të keqpërdorimit të burimeve shtetërore.

Kryetarët/et e Bashkive, sipas nenit 79 të Kodit Zgjedhor, përcaktojnë vendet publike në territorin e Bashkisë ku mund të afishohen materialet propagandistike të subjekteve politike. Nga Bashkitë objekt Monitorimi, KShH konstatoi se Bashkia Tiranë, Korçë, Elbasan dhe Durrës nuk respektojnë detyrimin ligjor për publikimin e vendimmarrjes për përcaktimin e vendeve të afishimit të materialeve propagandistike. Në Fier, më datë 21 prill, heqja e një banderole të subjektit LSI u bë shkak për konflikt midis dy kandidatëve për deputetë dhe mbështetësve të subjektit me punonjësit e policisë bashkiake të Fierit. Sipas të njëjtit nen të Kodit Zgjedhor në pikën 5, parashikohen rastet kur Policia Bashkiake mund të heqë materialet propaganduese⁴³.

Përgjatë muajit mars, u raportua se zyrat zgjedhore në Bashkitë Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër dhe Elbasan u ngritën para afatit ligjor të fushatës zgjedhore. Vërehet se zyrat zgjedhore të ngritura në këto Bashki para afatit ligjor të fushatës zgjedhore,

⁴² <https://www.facebook.com/104485125050487/posts/118996800265986/?sfnsn=mo> Përfshirja e Kryetares së Njësisë Administrative, Rajoni 4 Durrës

⁴³ <https://euronews.al/al/vendi/aktualitet/2021/04/21/perplasje-fizike-mes-anetareve-te-lsi-se-dhe-policise-bashkiake-ne-fier/>



pëmbajnë elementë të fushatës si logot, posterat dhe motot e subjekteve zgjedhore. Neni 79 i Kodit Zgjedhor parashikon afishimin e materialeve propagandistike pranë zyrave zgjedhore vetëm përgjatë fushatës zgjedhore.

Sipas vendimit nr. 6, datë 23/03/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në fasadat e institucioneve publike. Në Bashkinë Tiranë u raportua shkelje e dispozitës të sipërcituar, pasi në fasadën e Universitetit Politeknik të Tiranës u shfaqën materiale propagandistike të subjekteve zgjedhore. Në Bashkinë e Gjirokastrës u raportua për shfaqje të materialeve propagandistike të subjekteve zgjedhore në fasadën e Pallatit të Sportit.



Është evidentuar gjithashtu se institucionet publike kanë promovuar në rrjetet sociale subjekte zgjedhore apo kandidatë të caktuar. Gjatë inagurimit të Spitalit Rajonal të Fierit u evidentuan materiale propagandistike të një prej subjekteve zgjedhore.





4. HESHTJA ZGJEDHORE

Nga monitorimi i realizuar më datë 24 prill 2021, u vu re se heshtja zgjedhore u respektua pjesërisht në disa Bashkitë e monitoruara. Shkelje të nenit 77 të Kodit Zgjedhor për heshtjen zgjedhore u evidentuan në disa Bashki, përkatësisht në Elbasan, Vlorë dhe Tiranë, ku u raportua për shpërndarje të fletushkave, posterave dhe materialeve propagandistike në institucione publike dhe private; si dhe zyrat elektorale të cilat vijuan të jenë të ngritura dhe gjatë ditës së heshtjes zgjedhore. Nga ana tjetër, raportohet se mediat lokale kanë respektuar parashikimet e nenit 77 të Kodit Zgjedhor për heshtjen zgjedhore. Ndërkohë, KQZ nuk ka miratuar vendime për gjatësitë e subjekteve të cilët thyen heshtjen zgjedhore, në zbatim të nenit 174 të Kodit Zgjedhor.

Shpërndarja e materialeve zgjedhore

Kodi Zgjedhor parashikon se KQZ-ja dërgon materialet zgjedhore në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve. Nga monitorimi i realizuar, u evidentua se ky afat u respektua nga KQZ. Neni 100 i Kodit Zgjedhor parashikon një afat 15 orë para hapjes së votimit për dërgimin e materialeve nga KZAZ-të përkatëse drejt KQV-ve nën juridiksionin e tij. Ky afat, në një pjesë të madhe të KZAZ-ve, nuk u respektua⁴⁴. Shkak u bë, kryesisht, mungesa e koordinimit efektiv mes anëtarëve të KZAZ-ve, ndryshimet që pësoi anëtarësia e tyre, vonesat në emërimin dhe zëvendësimin e komisionerëve etj.

Monitorimi i vëzhguesve në Gjirokastrë u kufizua nga efektivët e policisë, në kundërshtim me nenin 7 të Kodit Zgjedhor, me pretendimin se në kohën e monitorimit nuk ishte mbyllur procesi i përgatitjes së QV-ve përkatëse⁴⁵. Kufizim u evidentua edhe në KZAZ nr. 40 në Tiranë ku u refuzua marrja e informacionit, ndërsa në KZAZ nr. 34 Tiranë u pengua prania e vëzhguesve dhe u refuzua dhënia e informacionit.

44 Konkretisht, në Elbasan KZAZ-të nr 47, 48, 49 dhe 50 ka vijuar procesi i shpërndarjes deri në orën 20.30, në KZAZ nr.4 në Shkodër, në orën 19.30 të datës 24 prill nuk ishin shpërndarë materialet zgjedhore për të paktën dy qendra zgjedhore, në KZAZ nr 31 në Tiranë shpërndarja filloi pas orës 15.00, çka e pamundësoi respektimin e afatit ligjor.

45 QV 4254, QV 42541, QV42542 dhe QV 4248



5. PROCESI I VOTIMIT

KShH zhvilloi procesin e monitorimit në 9 Bashki të Republikës së Shqipërisë⁴⁶ përgjatë ditës së votimit të Zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021. 140 vëzhgues u angazhuan në monitorimin e 324 Qendrave të Votimit.

Disa qendra votimi u hapën me vonesë, përafërsisht 30 min., për shkak të mosfunksionimit të pajisjes së identifikimit elektronik (PEI)⁴⁷, vonesa në paraqitjen e anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit apo vonesë në përgatitjen e sallës së votimit⁴⁸.

Aspekte procedurale të përdorimit të pajisjes PEI dhe timbrosjes së zgjedhësve

Me nisjen e procesit të votimit, u evidentuan raste të shumta të pezullimit të procesit të votimit për shkak të problemeve me funksionimin e pajisjes PEI⁴⁹. Për rrjedhojë, procesi i identifikimit të zgjedhësve u operua në menyrë manuale, duke verifikuar letërnjoftimin e paraqitur me anë të listave të zgjedhësve⁵⁰. Kjo solli për pasojë mungesën e praktikës së unifikuar të KQV, të cilat përdorën listën e zgjedhësve, përpos identifikimit nëpërmjet pajisjes PEI, ose vetëm nëpërmjet pajisjes PEI. Në rastet ku verifikimi i identitetit të zgjedhësve u bë nëpërmjet pajisjes PEI, KQV nuk udhëzoi zgjedhësit të nënshkruanin përbri emrit të tyre në listën e zgjedhësve⁵¹, apo t'i hiqej vizë emrit të tyre⁵². Gjithashtu, u raportuan raste ku shenjat e gishtërinjve të zgjedhësve nuk janë identifikuar nga pajisja PEI⁵³. U evidentuan raste të mosfunksionimit të kamerës së vëzhgimit në QV⁵⁴. Gjithashtu, është vërejtur se në disa QV zgjedhësit nuk u timbrosën⁵⁵ apo nuk u kontrolluan paraprakisht nëse ishin timbrosur, përpara se t'i jepej fleta e votimit⁵⁶. Në QV 3669, Bashkia Fier, QV 3653, Bashkia Korçë, u raportua se anëtarët e KQV nuk i kryen veprimet sipas rradhës së caktuar, duke lejuar zgjedhësit të ushtrojnë të drejtën e votës përpara se të timbrosen.

⁴⁶ Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Kukës, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Vlorë,

⁴⁷ QV 2374 Bashkia Elbasan, QV 4242/1 Bashkia Gjirokastrë, QV 2998 Bashkia Fier,

⁴⁸ QV 637/1 Bashkia Kukës

⁴⁹ QV 1743, 1732, 1856, 1767, 1804, 1887/1, 1819/1 Bashkia Tiranë, QV 3675/1 Bashkia Korçë, QV 4448, Bashkia Vlorë, QV 4238 QV 4242/1 Bashkia Gjirokastrë,

⁵⁰ QV 1411, 1411/3, 1429/2 Bashkia Durrës, QV 4447 Bashkia Vlorë, QV 3661/1, 3660 Bashkia Korçë

⁵¹ QV 1498, 1460 Bashkia Durrës, QV 0274, 0260 Bashkia Shkodër, QV 1767, 2002 Bashkia Tiranë,

⁵² QV 1767, 1804 Bashkia Tiranë, QV 4507/1 Bashkia Vlorë, QV 0260 Bashkia Shkodër

⁵³ QV 1460, Bashkia Durrës

⁵⁴ QV 1429/2, Bashkia Durrës

⁵⁵ QV 2390, Bashkia Elbasan, QV 4440, Bashkia Vlorë,

⁵⁶ QV 3641/1, Bashkia Korçë



Zëvendësime të anëtarëve të KQV

Në orët e para të veprimtarisë së QV nr. 2307 të Bashkisë Elbasan, u evidentua ndryshimi i një anëtarit të KQV-së, me vendim të KZAZ, për të cilin u mbajt procesverbal. Zëvendësimi i anëtarëve të KQV-ve që në orët e para të ditës së votimit nuk i shërben ecures normale të procesit të administrimit të procesit zgjedhor. Gjithashtu, në QV 0254/1, Bashkia Shkodër, u shkarkua një anëtar i KQV, i cili më pas u zëvendësua. Në QV 4258 të Bashkisë Gjirokastër, u pezullua procesi i votimit për shkak të zëvendësimit të një anëtarit të KQV-së.

Cënim të parimit të fshehtësisë së votës

Orientim/shoqërim i zgjedhësve nga persona të paautorizuar, anëtarë të KQV, vëzhgues të subjekteve zgjedhore

Përgjatë procesit të votimit, vëzhguesit sinjalizuan KShH-në lidhur me praninë e personave të paautorizuar, të cilët orientonin apo shoqëronin zgjedhësit për në qendrat e votimit⁵⁷. Është problematik fakti se anëtarët e KQV-së rrallëherë kanë marrë masa për largimin e personave të paautorizuar nga ambjentet e QV-së, nëpërmjet njoftimit të oficerëve të policisë. Në QV 0268 në Bashkinë Shkodër, u raportua se një person ka shoqëruar rregullisht me anë të automjetit të vetë zgjedhës në QV me qëllim për të votuar. Gjithashtu dhe në QV 3651 të Bashkisë Korçë, u raportua se një individ shpërndau postera të subjekteve zgjedhore dhe ushtroi ndikim te zgjedhësit. Për këtë, u njoftua policia nga kryetari i KQV-së, të cilët larguan individin dhe, për rrjedhojë, procesi rifilloi normalisht. Në QV 1932/1, u raportua prania e kryetarit të FRESSH⁵⁸ në njësinë nr. 8 në Bashkinë Tiranë, i cili udhëzonte zgjedhësit rreth mënyrës së votimit. Të tilla sjellje çënojnë integritetin e procesit zgjedhor.

Në kuadër të parimit të fshehtësisë së votës dhe respektimit të parimit se vota është e lirë, vëzhguesit raportuan raste ku votuesit shoqëroheshin dhe asistoheshin në dhomën e fshehtësisë nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore⁵⁹ apo anëtarët e KQV⁶⁰. Gjithashtu, janë evidentuar praktika të cënimit të fshehtësisë së votës pasi anëtarët e

⁵⁷ QV 255/1, 259 Bashkia Shkodër, QV 1844 Bashkia Tiranë, QV 3026/1 Bashkia Fier, QV 43131 Bashkia Gjirokastër,

⁵⁸ Grupimi rinor i Partisë Socialiste të Shqipërisë

⁵⁹ QV 1767/1, 1856, 1728 Bashkia Tiranë, QV 0250 Bashkia Shkodër,

⁶⁰ QV 259/1 Bashkia Shkodër, QV 260 Bashkia Shkodër



KQV kanë deklaruar me zë të lartë numrin rendor të zgjedhësve, i cili mbahet shënim nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore⁶¹.

Votimi familjar

Përsa i përket ndalimit të votimit familjar, vëzhguesit e KShH evidentuan raste të tilla në disa Bashki⁶². Në QV 1704/1, Bashkia Tiranë, është raportuar për votim familjar nga ana e një çifti, të cilët u vendosën bashkarisht në dhomën e fshehtësisë. Në QV 3651, Bashkia Korçë, u raportua për tentativë të votimit familjar, situatë e cila u ndreq nga anëtari i KQV-së, i cili ktheu mbrapsht zgjedhësit. Në QV 2374, Bashkia Elbasan, u parandalua tentativa për votim familjar nëpërmjet depozitimit të vërejtjes me shkrim nga vëzhguesi i KShH-së.

U evidentuan raste ku zgjedhësit kanë zbuluar votën e tyre gjatë palosjes së votës apo e kanë komunikuar atë me zë të lartë⁶³. Në QV 4510, anëtarët e KQV-së cilësuan votën e pavlefshme pasi u deklarua verbalisht nga zgjedhësi.

Fotografimi i votës dhe përdorimi i telefonit

Gjatë zgjedhjeve të 25 prillit 2021 pati vëmëndje të shtuar ndaj fotografimit të votës, çka përbën vepër penale, dhe përdorimit të telefonit gjatë procesit të votimit. KShH u sinjalizua për tentativa të fotografimit të votës⁶⁴ apo përdorimit të telefonit⁶⁵. Në QV 2012, Bashkia Tiranë, një zgjedhës tentoi të fotografojë fletën e votimit por u vu re prej anëtarëve të KQV-së dhe telefoni u sekuestrua. Për këtë rast, nuk pati ndërhyrje të Policisë së Shtetit. U vu re se jo në të gjitha rastet e dyshuara të fotografimit të votës është kërkuar ndërhyrja e oficerëve të policisë. Në QV 1845/3, në Bashkinë Tiranë dhe QV 4498/1, në Bashkinë Vlorë, u dokumentua fotografimi i votës dhe, për rrjedhojë, janë njoftuar oficerët e policisë. Policia nuk ndërmori hapa të mëtijshëm dhe votat u cilësuan të pavlefshme.

Respektimi i protokollit COVID-19

⁶¹ QV 260 Bashkia Shkodër, QV 1856 Bashkia Tiranë

⁶² QV 1411/2, 1489/1, 1449/2, Bashkia Durrës, QV 4235 Bashkia Gjirokastrë, QV 1724 Bashkia Tiranë, QV 364/1 Bashkia Korçë, QV 0255/1, 260 Bashkia Shkodër

⁶³ QV 3636/1, 3660, 4510 Bashkia Korçë, QV 2374 Bashkia Elbasan, QV 2355 Bashkia Durrës

⁶⁴ QV 3026, Bashkia Fier

⁶⁵ QV 1468/1, 1470/1, 1429 Bashkia Durrës, QV 3696/1, 3664/1 Bashkia Korçë, QV 1887/1 Bashkia Tiranë



Për shkak se procesi zgjedhor i Zgjedhjeve për Kuvend të 25 prillit u zhvilluan në kushtet e pandemisë Covid-19, Instituti i Shëndetit Publik dhe Komisioni Qendor i Zgjedhjeve publikuan protokollin i cili do ndiqej gjatë procesit të votimit. Në kundërshtim me parashikimin e protokollit se QV duhen pozicionuar në katin e parë të godinës, u raportuan raste ku QV ishin vendosur në katin e dytë⁶⁶. Gjithashtu, vëzhguesit sinjalizuan rregullisht se masat ndaj Covid-19 (*mbajtja e maskës, distancimi*) nuk u zbatuan në mënyrë të përgjegjshme dhe rigoroze⁶⁷.

Ndërhyrje e oficerëve të policisë

Në varësi të kërkesave të anëtarëve të KQV apo situatave të krijuara në ambientet e votimit gjatë procesit të votimit, vëzhguesit raportuan për ndërhyrje të oficerëve të policisë për të rivendosur rendin apo trajtuar raste të fotografimit të votës. Në QV 1767, Bashkia Tiranë, pas paraqitjes së vërejtjes për fotografim të votës nga vëzhguesja e subjektit zgjedhor⁶⁸, procesi i votimit u ndërpre, ndërkohë që oficerët e policisë morën të dhënat e personit dhe kërkuan procesverbalin e mbajtur nga Kryetarja e KQV. E njëjta situatë u paraqit dhe në QV 4498/1 në Bashkinë Vlorë.

Ofrimi i asistimit në votim

Përgjatë procesit të votimit, rregullisht në të gjitha Bashkitë, u raportuan raste të ofrimit të mbështetjes për të ushtruar të drejtën e votës ndaj personave të cilët ishin në pamundësi. Përgjithësisht, në të tilla situata, anëtarët e KQV kanë vepruar në përputhje me parashikimet ligjore. Ama, u evidentuan raste ku KQV lejoi ofrimin e asistencës nga një person që nuk ishte pjesë e listës zgjedhore ku ishte regjistruar personi që asistoi⁶⁹, lejoi që një person të ofrojë asistencë ndaj më shumë se një zgjedhësi⁷⁰ apo nuk dokumentoi rastet në protokoll⁷¹. Gjithashtu, në QV 3694, Bashkia Korçë, personi që ofroi mbështetje, zbuloi votën e personit të cilin asistoi.

Pengesa në ushtrimin e detyrës së vëzhguesit

⁶⁶ QV 0648, Bashkia Kukës

⁶⁷ QV 0255, QV 0256, QV 0316/1 Bashkia Shkodër; QV 3656, Bashkia Korçë; QV 1886, Bashkia Tiranë, QV 1489/1 Bashkia Durrës, QV 4507/1 Bashkia Vlorë, QV 3028/1 Bashkia Fier,

⁶⁸ Partia Demokratike

⁶⁹ QV 3641, 3635 Bashkia Korçë, QV 1457/1 Bashkia Durrës, QV 4510 Bashkia Vlorë

⁷⁰ QV 1732/1 Bashkia Tiranë

⁷¹ QV 4242/1 Bashkia Gjirokastrë,



Përgjithësisht, vëzhguesit e KShH-së kanë ushtruar funksionin e tyre pa ndeshur në barriera. Por, u raportuan raste të intimidimit, kërcënimit apo krijimit të pengesave. Në QV 0316/1 Shkodër, ndaj vëzhgueses u ushtrua intimidim dhe iu kërkua të largohej. Në QV 3026, Bashkia Fier, anëtari i KQV-së⁷² kërkoi nga vëzhguesi mos-raportimin e problemeve lidhur me fotografimin e votës. Në QV 2374/1, anëtari i KQV-së kundërshtoi mbajtjen e proces-verbalit për vërejtjen me shkrim të vëzhguesit të KShH-së.

Mbyllja e procesit të votimit

Në shumicën e QV-ve të monitoruara, procedura e mbylljes së procesit të votimit u zhvillua normalisht, në përputhje me parashikimet ligjore të mbylljes së QV-së në orën 19.00. Në disa QV pati vonesa deri në 1 orë për shkak të votuesit në rradhë dhe vonesave në mbylljen e procedurave të mbylljes së votimit⁷³. Në QV 2002, Bashkia Tiranë, u evidentua se ka patur mospërputhje midis numrit të zgjedhësve që kanë votuar dhe fletët e votimit të përdorura. Kjo mospërputhje u konstatua dhe u pasqyrua në protokollin e KQV-së. Materialet zgjedhore u nisën rregullisht për në VNV, shoqeruar nga sekretari, anetarë dhe oficer policie.

Procesi i votimit në I.E.V.P

Në fushëveprim të monitorimit të procesit të votimit, vëzhguesit e KShH u angazhuan në monitorimin e dy qendrave të posacme të votimit në I.E.V.P Drenovë (QV 3707/1) dhe në I.E.V.P Durrës (QV 14222). Në I.E.V.P Drenovë ushtruan të drejtën të votës 105 zgjedhës. Në I.E.V.P Durrës, procesi nisi me vonesë për shkak të mospërgatitjes në kohë të QV-së. Në QV 14222, vëzhguesja e KShH depozitoi vërejtje me shkrim lidhur me mos-regjistrimin e numrit të ID-së. U raportua se, përgjithësisht, zgjedhësve në këto QV nuk u është ofruar informacion për mënyrën dhe rregullat e reja të votimit.

Të tjera

⁷² Përkatësia politike: Partia Socialdemokrate

⁷³ QV 3016 Bashkia Fier (19.50); QV 260 (20.03), QV 259/1 (19.40), QV 259 (19.36) Bashkia Shkodër, QV 4440 Bashkia Vlorë (19.35), QV 0633 (20.01), QV 0648, QV 0649 (19.47) Bashkia Kukës



Vëzhguesit e pozicionuar në ZAZ nr. 40, ku u zbatua projekti pilot i votimit elektronik, raportuan se të moshuarit ndeshën vështirësi në ushtrimin e të drejtës së votës dhe, në disa raste⁷⁴, u asistuan nga të afërm të tyre.

Në Bashkitë e monitoruara u evidentuan 2 raste⁷⁵ të votimit nëpërmjet vendimit të gjykatës, për shkak të mungesës së emrit të zgjedhësit në listën zgjedhore.

Nëpërmjet raportimeve të vëzhguesve, vërehet se në disa QV⁷⁶, anëtarët e KQV kanë ushtruar të drejten e tyre të votës përpara përfundimit të procesit të votimit nga zgjedhësit, sic e parashikon Kodi Zgjedhor.

⁷⁴QV 1767, 1979/1 Bashkia Tiranë

⁷⁵ QV 1470, 1470/1, 1470/2, Bashkia Durrës

⁷⁶ QV 1932, Bashkia Tiranë, QV 1500/1 Bashkia Durrës



6. PROCESI I NUMËRIMIT

Në vijim të mbylljes së procesit të votimit për Zgjedhjet për Kuvend të 25 prillit 2021, KShH u angazhua në monitorimin e 12 Vëndeve të Numërimit të Votave në 9 Bashki. Parashikimi ligjor për mbërritjen në VNV të kutive të votimit të të gjitha QV-ve në juridiksionin e KZAZ-së brenda 3 orësh prej mbylljes së votimit, përgjithësisht, nuk u zbatua⁷⁷. Përshtim bën KZAZ nr. 11 Bashkia Kukës, KZAZ nr, 59 Bashkia Fier, KZAZ nr 73 Bashkia Korçë, të cilat përfunduan procesin e dorëzimit të kutive të votimit brenda afatit ligjor.

Në vijim të dorëzimit të kutive të votimit, vëzhguesit raportuan se KZAZ-të zhvilluan trajnimet e anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave. Në rastin e KZAZ nr. 48, në Bashkinë Elbasan, emërimet për anëtarë të GNV nuk ishin finalizuar në momentin e kryerjes së dorëzimit të kutive. Pas kryerjes së trajnimeve dhe veprimeve paraprake, votimi nisi përkatësisht në: 00.21 në KZAZ nr. 59 Bashkia Fier, 00.26 KZAZ nr. 73 Bashkia Korçë, 01.00 KZAZ nr. 74 Bashkia Korçë, 12.30 KZAZ nr. 30 Bashkia Tiranë, 01.15 KZAZ nr. 39 Bashkia Tiranë, 01.28 KZAZ nr. 11 Bashkia Kukës, 01.29 KZAZ nr. 80 Bashkia Gjirokastrë, 01.54 KZAZ nr. 48 Bashkia Elbasan, 02.14 KZAZ nr. 84 Bashkia Vlorë, 03.23 KZAZ nr. 21 Bashkia Durrës dhe 03.55 KZAZ nr. 24, Bashkia Durrës. Në Bashkinë Shkodër, procesi i numërimit filloi mëngjesin e datës 26 prill.

Përgjithësisht, procesi i numërimit u shoqërua me ndërprerje të vazhdueshme⁷⁸, shkaqet për të cilat u raportuan të jenë lodhja e anëtarëve të GNV⁷⁹, mosmarrëveshjet midis anëtarëve të GNV apo incidente për të cilat u nevojiti ndërhyrja e anëtarëve të KZAZ-së përkatëse apo e oficerëve të policisë. Për pasojë, procesi u ndesh në zvarritje të herëpashershme, pavarësisht thirrjeve të KQZ-së për përshtim dhe mosndërprerje të panevojshme të procesit. Gjithashtu, vëzhguesit raportuan se VNV-të ishin tepër të populluara, qoftë prej pranisë së lartë të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore por edhe të kandidatëve për deputet/e⁸⁰. Masat e vendosura si përgjigje ndaj pandemisë Covid-19 nuk u zbatuan rigorozisht, duke krijuar kështu një ambient të papërshtatshëm për të zhvilluar procesin në mënyrë të qetë dhe të sigurt.

77 KZAZ nr. 2 Bashkia Shkodër; KZAZ nr.30, 39 Bashkia Tiranë; KZAZ nr 21, nr. 24 Bashkia Durrës; KZAZ nr. 84 Bashkia Vlorë; KZAZ nr. 48 Bashkia Elbasan; KZAZ nr. 80 Bashkia Gjirokastrë,

78 KZAZ 39, Bashkia Tiranë

79 KZAZ 21, 24, Bashkia Durrës

80 KZAZ 21, 22 Bashkia Durrës



Përgjatë procesit të numërimit, vazhdimisht u raportua për prani të personave të paaautorizuar në ambjentet e numërimit të votave, pra të individëve të cilët nuk mbanin autorizimin e nevojshëm nga KQZ (*badge*) për të aksesuar VNV-të apo individë që shkëmbenin *badge*-in me njëri-tjetrin me qëllim për të qendruar në ambjentet e VNV-së. U evidentua se individë të tillë kishin ndërveprim të rregullt me anëtarët e GNV-ve apo të KZAZ-së përkatëse⁸¹, duke cënuar ushtrimin e pandikuar të funksioneve të administratës zgjedhore. Gjithashtu, u raportua se vëzhguesit e subjekteve zgjedhore shpreheshin publikisht mbi vlefshmërinë e fletëve të votimit, në përpjekje për të ndikuar apo t’iu imponuar vendimmarrjes së anëtarëve të GNV-ve. Elementët e mësipërm cenojnë zhvillimin e qetë të procesit të numërimit dhe krijojnë trysni ndaj numëruesve, të cilët ndeshnin ndërhyrje të personave të pranishëm në ambjentet e VNV-ve apo vendimet e të cilëve kritikoheshin haptazi nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, paçka se kjo e drejtë nuk i njihet.

Përsa i përket veprimtarisë së anëtarëve të GNV-ve, u raportua se fletët e votimit janë shfaqur qartësisht në ekran, duke mundësuar dallimin e fletës së votimit nga vëzhguesit e pranishëm. Ritmet u perceptuan prej vëzhguesve të KShH-së si relativisht të ngadalta⁸², me rastin e KZAZ nr. 73 në Bashkinë Korçë që numëronte mesatarisht 1 kuti votimi në orë. Numëruesit kishin në dispozicion një manual për të konsultuar në rast të paqartësive të mundshme lidhur me procesin e punës, çka sinjalizon mosnjohjen e procesit nga anëtarët e GNV-ve dhe nevojën për të zhvilluar trajnimet e anëtarëve të administratës zgjedhore në kohë.

Përgjatë procesit të numërimit u raportuan dhe incidente mes personave të pranishëm në ambjentet e VNV-ve, për të cilat është nevojitur ndërhyrja e oficerëve të policisë për të rivendosur rendin në mënyrë që procesit i numërimit të vijojë i pandërprerë⁸³. Në KZAZ 30, Bashkia Tiranë, u raportua mbi incidentin e ndodhur mes vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. U raportua se përleshja fizike ndodhi për shkak se letërnjoftimet e disa individëve nuk korrespondonin me të dhënat e reflektura në *badge* të lëshuar nga KQZ. Personat u shoqëruan nga oficerët e policies dhe procesi i numërimit u pezullua për të rifilluar në mëngjesin e ditës tjetër.

Monitorimi i procesit të numërimit ka sinjalizuar një numër të lartë të fletëve të votimit të cilësuar të pavlefshme nga anëtarët e GNV-ve. Implementimi për herë të parë i votimit preferencial për kandidatët/et dhe shtrirja e pamjaftueshme në kohë e fushatës së informimit lidhur me modelin e fletës së votimit krijuan premisa për të

81 KZAZ 30, Bashkia Tiranë; KZAZ 24, Bashkia Durrës; KZAZ 50, Bashkia Elbasan; KZAZ 84, Bashkia Vlorë; KZAZ 2, Bashkia Shkodër; KZAZ 74, Bashkia Korçë; KZAZ 59, Bashkia Fier

82 KZAZ 30, Bashkia Tiranë; KZAZ 50, Bashkia Elbasan; KZAZ 84, Bashkia Vlorë

83 KZAZ 22, Bashkia Durrës; KZAZ 49, Bashkia Elbasan;



patur një numër të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Për shkak të paqartësive lidhur me mënyrën e votimit, shumë zgjedhës kanë votuar në mënyrë të atillë që sillte për pasojë pavlefshërinë e fletës së votimit. Por, janë evidentuar raste ku cilësimi i fletës së votimit të pavlefshme ka ardhur si pasojë e mosnjohjes së legjislacionit nga ana e anëtarëve të GNV-ve. Në rastin e KZAZ nr. 84 në bashkinë Vlorë, është raportuar se fletët e votimit të cilat përmbanin votën e dy kandidatëve të të njejtit subjekt zgjedhor cilësoheshin të pavlefshme, në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor të cilat parashikojnë se një votë e tillë konsiderohet e vlefshme dhe i shkon vetëm subjektit zgjedhor.